

V E N D I M
Nr. 475, datë 31.8.2000

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS, TË
SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" dhe të nenit 9, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2000" me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit rrugor në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.
2. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës së shpërblimit përkatës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 8 864 733 (tetë milionë e tetëqindëgjatëdhjetekatër mijë e shtatëqindetridhjetetre) lekësh.
3. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, përballohet nga fondi i kontigjentit së Këshillit të Ministrave.
4. Ky shpronësim bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të përfundojë brenda muajit shtator 2000.
5. Punimet për ndërtimin e kryqëzimit rrugor fillojnë brenda muajit shtator dhe përfundojnë brenda 3 muajve nga dita e fillimit të tyre.
6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LLOJI I PASURISË SË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHET

Nr.	Emri	Sipërfaqja në m2		Çmimi në L/m2	Vlera në lekë
		Tokë Bujq.	Truall		
1.	Sindikatat (në proces ide-ntifikimi)		2421	3661.6	8864733.6